



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Dokument parlamentar

Tiranë, 3 tetor 2016

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8577, DATË 10.02.2000 “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E GJYKATËS KUSHTETUESE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

1. HYRJE

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, i krijuar me vendimin nr. 96/2014, të Kuvendit të Shqipërisë, në përputhje me objektin e veprimtarisë së tij, ka analizuar gjendjen aktuale të organizimit dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë, ka hartuar një dokument strategjik për objektivat e reformës në sistemin e drejtësisë, si dhe ka propozuar për miratim një paketë të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislacionit, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë. I gjithë ky proces është realizuar me kontributin dhe mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, subjekteve të tjera të interesuara dhe opinionit publik.

Me vendimin nr.14, datë 30.07.2015 Komisioni ka miratuar Dokumentin “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, me të cilin është përmbyllur fazën e I-rë e procesit. Ky është i pari dokument gjerësisht i konsultuar në publik që analizon mbi baza objektive, shkencore dhe profesionale, nga pikëpamja ligjore dhe zbatueshmërisë së ligjit, gjendjen aktuale të sistemit të

drejtësisë dhe të gjitha ato problematika akute që kanë prekur këtë sistem, në drejtim të organizimit, funksionimit, mirëqeverisjes, efijencës dhe administrimit të tij.

Komisioni i Posaçëm, me vendimin nr.15, datë 30.07.2015 ka miratuar në parim dokumentin “Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë”, si dhe Planin e Veprimit për zhvillimin e strategjisë për reformimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, dokumente të cilat përmbyllën Fazën e II-të të procesit dhe që kanë detajuar në masa konkrete objektivat strategjike të reformës në sistemin e drejtësisë, duke evidentuar gjithashtu ligjet, të cilat do t’i nënshtrohen ndërhyrjes në fazën e tretë të veprimtarisë së këtij Komisioni.

Faza e tretë e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm, filloi me punën e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë (vendas dhe ndërkombëtarë) për hartimin e ndryshimeve kushtetuese dhe një pakete ligjesh shoqëruese, midis tyre dhe të projektligjit për Gjykatën Kushtetuese.

2. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në Dokumenti “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, sa i përket Gjykatës Kushtetuese, është evidentuar domosdoshmëria e reformimit të saj. Zbatimi i ligjit organik nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” ka nxjerrë në pah jo pak çështje problematike në drejtim të efijencës dhe qenies së saj një mjet efektiv. Gjykata Kushtetuese gjatë praktikës dhe veprimtarisë së saj ka hasur në disa pengesa kushtetuese dhe ligjore, të cilat në disa raste kanë sjellë si pasojë mosfunksionimin efikas nga pikëpamja organizative ose mosqenien efektive në ushtrimin e kompetencave që i janë njohur nga Kushtetuta.

Dokumenti “Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë” si objektiv ka parashikuar dhe “*Rritjen e efijencës dhe efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese në nivel ligjor*”. Në Plan Veprimin e Reformës në Sistemin e Drejtësisë është parashikuar që, në kuadër të këtij objektivit, të hartohet dhe ligji organik për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese.

Për shkak të një vijimësie kushtetuese të këtij institucioni të rëndësishëm në rishikimin që i është bërë Kushtetutës, si në drejtim të misionit dhe vendit që zë në raport me institucionet e tjera kushtetuese, ashtu edhe të mosndryshimit të kompetencave kryesore apo të subjekteve inicuese të gjykimit kushtetues, orientimi kryesor i hartuesve të projektligjit ka qenë, pikësëpari, bërja e shtesave e ndryshimeve thelbësore mbi ligjin ekzistues dhe jo domosdoshmërisht në përgatitjen e një ligji të ri. Efektet përgjithësisht pozitive që ka dhënë ligji ekzistues krijojnë hapësira për më shumë amendime të dispozitave të tij, se sa për një ligj të ri.

Synimi kryesor i projektligjit është përshtatja e tij me ndryshimet kushtetuese të propozuara, që lidhen kryesisht me ndryshimin e procedurës së emërimit, kriteret profesionale dhe kushtet për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, përgjegjësinë e tyre disiplinore, kufizimin e

imunitetit, papajtueshmëritë, rastet e përfundimit të mandatit, si dhe disa aspekte që lidhen me procedurat që ndiqen në Gjykatën Kushtetuese.

Ky projektligj synon ta bëjë Gjykatën Kushtetuese më efektive në vendimmarrje. Duke qenë se ligji bazë është miratuar në vitin 2000, gjatë kohës së zbatimit të tij ka dalë nevoja për përmirësimin e tij dhe rregullimin e instituteve të parregulluara ose të rregulluara jo plotësisht. Gjithashtu, disa aspekte kërkojnë përshtatje me standardet më të mira, me qëllim jo vetëm funksionimin e vetë organit kushtetues, por edhe qëllimit final për të cilin ai është krijuar, pra, mbrojtjes së Kushtetutës, në drejtim të kufizimit të hapësirës së organeve për të abuzuar me pushtetin, si dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit.

3. HARTIMI I PROJEKTLIGJIT DHE KONSULTIMI PUBLIK

Projektligji është hartuar nga nëngrupi i Reformës Kushtetuese dhe Gjykatës Kushtetuese, bazuar në Dokumentin Analitik, Strategjinë e Reformës në Drejtësi dhe Planin e Veprimit të ndërtuar për këtë qëllim. Dokumenti “Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë” ka parashikuar si objektiv “Rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të Gjykatës Kushtetuese në nivel ligjor”. Sipas këtij dokumenti objektivat kryesorë lidhur me efikasitetin dhe efektivitetin e Gjykatës Kushtetuese do të arrihen me anë të ndërhyrjeve në ligjin organik, duke synuar:

- përcaktimin e kriterëve të qarta për realizimin e procesit të emërimit dhe të përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve;
- përmirësimin e strukturës organizative të GJK-së;
- përjashtimin me Kushtetutën të subjekteve që legjitimohen t’i drejtohen GJK-së;
- parashikimin e afateve më të arsyeshme për disa nga procedurat që parashikohen në ligj si dhe detajimin e procedurave të veçanta;
- mbrojtjen dhe garantimin efektiv të të drejtave dhe lirive themelore të individit, duke parashikuar procedurat që mungojnë në ligj;
- rregullimin e ligjit në funksion të bërjes së GJK një mjet efektiv, në përputhje me nenin 13 të KEDNJ-së;
- përjashtimin me Kushtetutën të parashikimeve ligjore, që lidhen me efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe qartësimin e fuqisë prapavepruese të këtyre vendimeve.

3.1 Gjithpërfshirja

Grupi i punës i ngarkuar për hartimin e amendamenteve të ligjit nr.8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” filloi veprimtarinë në fund të muajit nëntor 2015. Në përbërje të grupit të punës për hartimin e projektligjit kanë qenë ekspertë të nivelit të lartë, vendas dhe të huaj (përfaqësues të Misionit Euralius IV). Grupi i punës është asistuar nga ekspertët e Sekretariatit Teknik, i përbërë nga juristë, përfaqësues të Gjykatës Kushtetuese dhe të Kuvendit, si dhe nga ekspertë të opozitës dhe ekspertë të grupit Think Tank.

Hartimi i dispozitave të projektligjit është mbështetur kryesisht në “Dokumentin Vlerësues për Hartimin e Ligjit” dhe në një projekt fillestar, të punuar nga ekspertët e Sekretariatit Teknik.

3.2 Transparenca dhe konsultimi publik

Pas disa takimeve të zhvilluara në muajin Dhjetor të vitit 2015, të gjithë anëtarët e grupit të punës u angazhuan të pasqyronin në projektligj vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Nga fundi i muajit janar deri në fund të muajit maj 2016, grupi i punës ka zhvilluar takime të shpeshta periodike, si dhe janë zhvilluar 11 mbledhje me përfaqësues të grupit të konsultimit *Think Tank*, duke përfshirë në takimet e para edhe përfaqësuesit e opozitës dhe në vijimësi takime me gjyqtarë, këshilltarë ligjorë të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, institucioneve ndërkombëtare, pedagogë të Fakultetit të Drejtësisë etj.

Në dy takime të veçanta është rishikuar i gjithë teksti i projektligjit në dritën e sugjerimeve dhe rekomandimeve të sjella nga grupi *Think Tank*, në lidhje me terminologjinë, teknikën legjislative, si dhe përditësimin e tij me projektamendamentet kushtetuese. Gjatë këtyre takimeve, projektligji ka pësuar ndryshime të ndjeshme në të gjitha pjesët e tij, ku është vlerësuar ndërhyrja si e domosdoshme. Fillimisht, projekti është bazuar në projektamendamentet kushtetuese të datës 12 janar 2016 dhe, në vijimësi, ka reflektuar ndryshimet e nevojshme, duke ndjekur ndryshimet që pësuan projektamendamentet kushtetuese, për shkak edhe të Opinionit të Ndërmjetëm, si dhe të Opinionit Përfundimtar të Komisionit të Venecias, të datës 14 Mars 2016.

Në datën 17 Maj është zhvilluar konsultimi publik për këtë projektligj. Në këtë tryezë të zgjeruar konsultimi, por edhe më pas, janë mbledhur komente nga grupet e interesit, si institucione, organizata të shoqërisë civile, pedagogë, gjyqtarë dhe prokurorë. Për shkak të këtyre konsultave, projektligji ka qenë në proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe përmirësimi. Një pjesë e konsiderueshme e sugjerimeve dhe rekomandimeve të propozuara nga grupet e interesit dhe grupi i konsultimit *Think Tank* janë bërë pjesë përbërëse e projektligjit.

4. VLERËSIMI I KUSHTETUTSHMËRISË, HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI DHE ME PROGRAMIN E DOKUMENTET POLITIKE TË REFORMËS NË DREJTËSI

Projektligji është hartuar në bazë e për zbatim të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara në Kuvendin e Shqipërisë, në 22 korrik 2016, me ligjin nr.76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, konkretisht të neneve 124-134, 179, 179/b, si dhe të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, projektligji respekton standardet që vendosin aktet ndërkombëtare në lidhje me këtë fushë.

Projektligji është në përputhje të plotë me dokumentet “Strategjia e Reformës në Sistemin e Drejtësisë” dhe “Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri”, të miratuara nga Komisioni i Posaçëm për Reformën në Drejtësi.

Projektligji është harmonizuar me legjislacionin shqiptar në fuqi, si dhe me projektligje të tjera që po hartohen dhe do të miratohen në mbështetje dhe në zbatim të ndryshimeve kushtetuese.

5. PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji ka prekur një pjesë të konsiderueshme dispozitash të ligjit aktual, konkretisht:

- a) Dispozitat lidhur me emërimin e gjyqtarëve të GJK dhe zgjedhjen e Kryetarit të saj, referuar amendamenteve kushtetuese për këtë qëllim;
- b) Dispozitat lidhur me përfundimin e mandatit, papajtueshmërinë dhe procedimin disiplinor të gjyqtarëve, sipas amendamenteve kushtetuese;
- c) Dispozitat lidhur me organizimin e brendshëm të Gjykatës, statusin dhe riorganizimin e shërbimit ligjor;
- ç) Dispozitat lidhur me procedurat e gjykimit duke përfshirë: kriteret për paraqitjen e kërkesave, afatet e ndryshuara për paraqitjen e kërkesave, fazën e seleksionimit paraprak të tyre, përfaqësimin ligjor të palëve;
- d) Dispozitat referuar gjykimit në themel të disa procedurave gjykimore si: ankimi kushtetues individual, shkarkimi i Presidentit, shqyrtimi i kërkesave për referendum dhe rezultateve të tij, papajtueshmëria në ushtrimin e funksioneve të Presidentit dhe të deputetëve, etj.

Më në detaje, projektligji sjell këto ndryshime dhe shtesa:

Kreu I e forcon më shumë rolin dhe pavarësinë e GJK duke theksuar pavarësinë e buxhetit të saj, si dhe funksionin e saj si organi që zgjidh mosmarrëveshjet e natyrës kushtetuese. Gjithashtu, në këtë kre bëhet një ndryshim, duke i dhënë Rregullores së GJK një rol më të rëndësishëm në parashikimin e rregullimeve nga vetë GJK, sa i takon procedurave të gjykimit që kërkojnë më shumë hollësi, me qëllim që ligji të mos rëndohet nga rregullime të tepërta. Kjo Rregullore do të ketë jo vetëm fuqinë e një akti rregullues të brendshëm, por do të shërbejë edhe si akt burimor për procesin vendimmarrës të GJK, si një mënyrë për të forcuar vetëorganizimin dhe pavarësinë e saj.

Në **Kreun II** janë bërë disa ndryshime dhe shtesa duke filluar me ndryshimin e titullit të Kreut, në “Emërimi, zgjedhja dhe mbarimi i mandatit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.”, gjë që e orienton këtë kre më mirë drejt përmbajtjes reale që ai ka. Dispozitat e para të këtij kreu të ndryshuara dhe të shtuara lidhen me procesin e ri të emërimit/zgjedhjes së gjyqtarëve të GJK, që tashmë vjen si rrjedhojë e ndryshimeve kushtetuese, të parashikuara në nenin 125 të Kushtetutës. Më tej, janë parashikuar kritere dhe kushte të hollësishme që duhen plotësuar nga kandidatët për gjyqtarë të GJK. Ky është një rregullim i rëndësishëm i këtij projektligji që plotëson një boshllëk në kuadrin kushtetues dhe ligjor të GJK. Po në këtë kre, janë përcaktuar saktë rastet e përfundimit të mandatit të anëtarit të GJK dhe afatet brenda të cilave kërkohet që të plotësohet vendi vakant.

Një nga risitë e këtij kreu është parashikimi i procedurës, shkeljeve dhe masave disiplinore për anëtarët e GJK, si një nga objektivat kryesore të Reformës në drejtësi me qëllim rritjen e shkallës së përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies jo vetëm me masën më ekstreme që është shkarkimi, por edhe me masa të tjera, si të gjithë gjyqtarët. E veçanta këtu qëndron tek fakti se në respektim të pavarësisë së GJK, ky proces zhvillohet nga vetë anëtarët e GJK dhe jo nga një organ tjetër. Për vet specifikën që ka kreu II në ligjin ekzistues, është menduar veçimi i disa dispozitave të tij, që lidhen me funksionin administrativ të Kryetarit dhe të Mbledhjes së Gjyqtarëve, në shtesën e Kreut II/1, të titulluar “Organizimi i Gjykatës Kushtetuese”.

Janë bërë disa përmirësime sa i takon administratës së GJK, duke përcaktuar më mirë statusin dhe rolin e saj, referuar edhe ligjit të ri për shërbimin civil. Një risi që sjell ky projektligj në këtë kre është edhe ngritja e Njësisë së Shërbimit Ligjor, bazuar në kritere të larta profesionale, që do të kryejë funksionet e një bërthame që ofron këshillim dhe ndihmë ligjore në procesin vendimmarrës, i cili deri tani është kryer nga këshilltarët ligjorë, statusi dhe roli i të cilëve ka qenë i parregulluar më parë me asnjë akt ligjor ose nënligjor. Në parashikimin e kësaj njësie është mbajtur parasysh që të ketë një ndërthurje të përvojave profesionale (magjistratë dhe jo magjistratë), ashtu si edhe për gjyqtarët që emërohen në këtë Gjykatë, me qëllim rritjen e cilësisë së vendimmarrjes të saj.

Në kreun III që titullohet “Statusi i Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese”, janë reflektuar ndryshimet kushtetuese në drejtim të imunitetit dhe të rasteve të papajtueshmërisë.

Në kreun IV janë bërë ndryshime dhe shtesa që lidhen me zhvillimin sa më mirë të gjykimit para GJK duke detajuar mënyrën e përfaqësimit dhe të zhvillimit të seancave gjyqësore.

Në kreun V dhe VI janë propozuar shumë ndryshime që lidhen me të gjithë hapat proceduralë që ndiqen nga palët në proces, si edhe të gjitha veprimet që kryen GJK, në fazën e shqyrtimit paraprak dhe në seancë plenare. Janë parashikuar kritere më të detajuara që duhet të plotësojë një kërkesë që paraqitet para GJK, me qëllim zhvillimin e një procesi cilësor vendimmarrës, por edhe të qenies më efikase të GJK. Gjithashtu, propozohen sugjerime për të ndihmuar vendimmarrjen me një përfaqësim sa më cilësor, por edhe të parandalimit të rritjes së tepërt të ngarkesës, sa i takon kërkesave që nuk mund të pranohen për shqyrtim, pasi janë gjykuar më parë ose janë në kundërshtim me natyrën e gjykimit të GJK. Gjithashtu, janë rishikuar rregullat lidhur me vendimmarrjen e GJK, nga momenti që çështja kalon për gjykim dhe deri në shpalljen e vendimit, fazë e cila duhet pranuar se zgjat mjaft dhe nuk i shërben transparencës dhe gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Për të eliminuar këtë problem është parashikuar që seanca gjyqësore të zhvillohet vetëm pasi çështja të jetë e përgatitur mirë nga relatori dhe vendimi mbi çështjen të merret mbi bazën e një projektvendimi të përgatitur nga relatori i çështjes. Menjëherë pas votimit mbi projektvendim, zbardhja e vendimit përfundimtar është i mundur të bëhet brenda disa ditësh. Në këtë mënyrë, synohet të shmanget publikimi vetëm i dispozitivit të vendimit dhe dalja e

arsyetimit të plotë pas disa javësh ose muajsh, duke eliminuar edhe perceptimet jo të drejta të publikut sa i takon transparencës së vendimmarrjes së GJK.

Kreu VII sjell përmirësime të ndjeshme të procedurave të veçanta të gjykimit kushtetues. Në dispozitat e këtij Kreu ka ndryshime, kryesisht, në drejtim të subjekteve që vënë në lëvizje GJK, ndryshime të cilat rrjedhin për shkak të ndryshimeve të nenit 134 të Kushtetutës, ashtu siç ka ndryshime sidomos të afateve procedurale, të cilat janë shkurtuar ndjeshëm. Nga afati 2 vjeçar për kërkesat individuale është propozuar afati 4 mujor dhe nga 3 vjet që ishte afati për kundërshtimin e akteve normative është bërë 2 vjet. Po kështu janë detajuar në procedurë, afate dhe subjekte kërkuese disa procedura gjykmorë që kanë qenë të parregulluara fare, ose të rregulluara jo mjaftueshëm nga ligji ekzistues, të tilla si: zgjedhshmëria e deputetëve, shkarkimi i Presidentit të Republikës, shqyrtimi i papajftueshmërisë së deputetëve, shqyrtimi i çështjeve të referendumit, etj. Një vend të veçantë zë edhe ankimi individual kushtetues, i cili mungon në ligjin ekzistues, megjithëse zë pjesën më të madhe të vendimmarrjes së GJK. Në këtë kre, është shtuar gjithashtu edhe shqyrtimi i detyrimeve që rrjedhin nga gjykatat ndërkombëtare, vendimet e të cilave sjellin detyrime për GJK. Ky projektligj ofron një mbrojtje më të madhe të individit, por edhe një mundësi për të shtuar rastet e riparimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut brenda sistemit kombëtar, me synimin për të ulur ndjeshëm rastet e konstatimit të shkeljeve nga GJEDNJ-ja.

Kreu i fundit lidhet me disa ndryshime në efektet e vendimeve të GJK, si dhe të ekzekutimit të tyre. Duke qenë se nuk mund të ketë mjete të tjera efikase për zbatim të vendimit të GJK, përveç vullnetit të organeve shtetërore ose jopublike për zbatimin e tyre, është sugjeruar që mosrespektimi i vendimeve të saj, në rast se është i qëllimshëm, të mund të çojë deri në përgjegjësi penale, sipas kërkesave të ligjit.

6. SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJIT NË KOMISIONIN E POSAÇËM PËR REFORMËN NË DREJTËSI

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” është shqyrtuar në Komisionin e Posaçëm parlamentar në mbledhjet e datave 20, 22 qershor, 26 dhe 28 shtator 2016. Komisioni caktoi relator për këtë projektligj anëtarin e Komisionit, deputetin Pandeli Majko.

Në mbledhjen e datës 20 qershor u bë prezantimi në parim i projektligjit nga dy ekspertët e nivelit të lartë pranë komisionit të posaçëm, z.Sokol Sadushi dhe z. Rainer Deville.

Në prezantimin e projektligjit, z. Sokol Sadushi theksoi se në vëmendje të grupit të punës për përgatitjen e këtij projektligji ka qenë analiza e gjetjeve në tërësi dhe strategjia e drejtësisë, pasi ato kanë evidentuar si problematike domosdoshmërinë e qenies së GJK një mjet efektiv. Në projektligj janë trajtuar çështjet që kanë të bëjnë me mënyrën e zgjedhjes së gjyqtarëve

kushtetues, kriteret e qarta profesionale, të cilat duhet të përmbushin kandidatët për gjyqtarë të GJK, si dhe me përmirësimin e ndjeshëm të procedurave të gjykimit kushtetues. Gjithashtu në projektligj është bërë një lloj ridimensionimi i subjekteve iniciuese në GJK, me një saktësim më të mirë të juridiksionit të GJK, duke pasur gjithmonë në vëmendje faktin se jurisprudenca e GJEDNJ-së shpeshherë ka ndëshkuar Shqipërinë. Për rrjedhojë, në mënyrë indirekte, ka dalë edhe një problematikë që lidhet me mënyrën sesi GJK gjykon çështjet, qoftë për shkak të mënyrës së vendimmarrjes së saj, qoftë edhe për shkak të ligjit të saj. Mbi këtë orientim është parashikuar dhënia e një pozicioni më aktiv të individit në raport me këtë gjykatë, si edhe parashikimi i afateve më të shkurtra, që lidhen me mënyrën e gjykimit nga ana e GJK.

Nga anëtarët e Komisionit u kërkuan sqarime lidhur me afatet procedurale në rastin e emërimeve, kriteret për gjyqtarët që zgjidhen në GJK, mbi praktikën e ndryshme që parashikon projektligji për institucione të ndryshme në momentin e emërimit, si dhe lidhur me diferencën apo me qëndrime të ndryshme për organet që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, që të shprehen për kandidatët. Në sqarimet që u dhanë nga ekspertët lidhur me afatet që lidhen me momentin kur ndërhyjnë Kuvendi, Presidenti dhe Gjykata e Lartë, vlerësohet se ato nuk janë shumë të shkurtra, pasi periudha tremujore përpara përfundimit të mandati ka shërbyer për një lloj gjykimi publik të kandidaturave.

Lidhur me pyetjen për sa i përket diferencimit që është bërë për zgjedhjen e gjyqtarëve nga Gjykata e Lartë me dy votime, në raport më atë që bëhet me Kuvendin, ekspertët sqaruan se është bërë me qëllim diferencimin e institucionit politik nga ai gjyqësor. Për Kuvendin është zgjedhur ky votim ndoshta edhe për shkak të qasjes që ka reforma apo i gjithë procesi për një lloj depolitizimi të procesit dhe për një lloj ndikimi sa më pozitiv ndaj ligjvënësit për të vepruar qoftë edhe më një votim. Sa i takon pyetjes për përgatitjen e dy listave me kandidatë të veçantë të parashikuar për zgjedhjen e gjyqtarëve nga Presidenti dhe Kuvendi nga ekspertët u dha sqarimi se kjo i shërben situatës së veçantë kur krijohen më shumë se një vend vakant për secilin organ emërtese. Në këtë rast një nga kandidatët do të zgjidhet nga gjyqtarët dhe një nga juristët e tjerë me qëllim përzierjen e përvojave mes gjyqtarëve kushtetues.

Për sa i përket pyetjes që lidhet me kriteret, në fakt, u shpjegua se çështja e kriterit apo e vjetërsisë 15 vjet është një çështje shumë e diskutueshme. Zgjidhja që është dhënë për 15 vjet vjetërsi është rrjedhojë e amendamenteve kushtetuese nuk është rrjedhojë e ligjit. Pra, është e imponuar nga ulja e viteve në amendamentet kushtetuese për sa i përket përzgjedhjes së gjyqtarëve kushtetues dhe të gjyqtarëve të lartë, që automatikisht e ka sjellë efektin e tij edhe në projekt ligjin për GJK. Lidhur me kriteret në ligj është synuar që të jenë sa më të detajuara, ndryshe nga ligji ekzistues, për të evidentuar qartësisht cilësinë e kandidatëve që duhet të përzgjidhen për gjyqtar kushtetues.

Në mbledhjen e datës 22 qershor Komisioni filloi diskutimin nen për nen të projektligjit. Gjatë këtij shqyrtimi, nga anëtarët e Komisionit u kërkuan sqarime për disa nga nenet e projektligjit.

Konkretisht diskutime pati lidhur me nenin 4 të projektligjit, për buxhetin e GJK. Nga deputetët u sugjerua që varianti në fuqi është më i përshtatshmi pasi ka një raport të caktuar midis propozimit të buxhetit nga gjykata dhe paraqitjes në Kuvend të buxhetit të GJK.

Pati diskutime sa i takon edhe statusit të Njësisë së Shërbimit Ligjor që krijohet për herë të parë. Deputetët sugjeruan që rreth gjysma e tyre të jenë magjistratë dhe gjysma juristë me përvoja të tjera profesionale në fusha të ndryshme të së drejtës, sipas kritereve të parashikuara në ligj. Këta të fundit do të jenë të përhershëm, me qëllim ruajtjen e bërthamës shkencore brenda GJK dhe vazhdimësinë e jurisprudencës, pavarësisht përtëritjes së GJK. Ideja u mbështet nga komisioni.

Lidhur me zgjedhjen e kryetarit dhe me kufizimin e mandatit të tij, ekspertët shpjeguan se përgjithësisht pranohet përvoja e vendeve të tjera, që kryetarët nuk kanë kufizime në mandat për tu rizgjedhur. Është në të drejtën legjitime të trupës për të zgjedhur atë që ata mendojnë se do t'i drejtojë. Kushtetuta këtë lloj frymëmarrje kërkon të japë. Edhe dhe ligji këtë synon të zgjidh duke i lënë hapësirë kandidatëve të të pëlqyeshme për tu zgjedhur nga vetë trupa e gjyqtarëve.

Për sa i përket nenit 83, që bën fjalë për arsyetimin e vendimit, u diskutua nëse në situata e jashtëzakonshme që ka vendimmarrja mund të lihet një afat më i ngushtë. Sipas ekspertëve, vendimi duhet të shpallet kur të jetë gati dhe ky është instrumenti i duhur për GJK. Ata nuk duhet të vendosin menjëherë, por të marrin kohën për të hartuar vendimin dhe më pas vendimi të shpallet pasi të jetë i arsyetuar. Ky është dhe perceptimi publik për GJK. Në arsyetimin e tyre, më tej ekspertët theksuan se është parashikuar në projektligj që në raste të veçanta, dhe kjo varet në përgjegjshmërinë e gjyqtarëve, mund të shpallet të paktën dispozitivi, duke i detyruar gjyqtarët që të respektojnë afatin 30 ditor për arsyetimin e vendimit. Pra, afatet janë plotësisht të arritshme nëse ndiqet kjo metodë pune nga GJK. Aktualisht, në ligjin ekzistues, nuk ka afat për shpalljen e vendimit, dhe në praktikë ka ndodhur që pas shpalljes së dispozitivit, arsyetimi i vendimit është bërë pas disa muajsh. Në përfundim të diskutimit të kësaj çështjeje, deputetët u shprehën se janë dakord me arsyetimin dhe sugjerimet e ekspertëve, por në projektligj duhet të reflektohet ky proces në mënyrën më të mirë të mundshme, duke mbajtur parasysh edhe rastet përjashtimore.

Diskutimi nen për nen i projektligjit në Komisionin e Posaçëm vazhdoi në mbledhjet e datave 26 dhe 28 shtator 2016. Në këto mbledhje nga ekspertët u bë një paraqitje e ndryshimeve që janë bërë në projektligj, me qëllim harmonizimin me ndryshimet kushtetuese dhe me ligjet e tjera prioritare. Gjithashtu u diskutuan në Komision propozimet e ardhura nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me projektligjin.

Më konkretisht, ndryshimet që u bënë në këto dy mbledhje konsistojnë në :

- Në rastet kur ka dy vende vakante njëkohësisht Këshilli i Emërimeve në Drejtësi harton dy lista me kandidatë, ku njëra listë është me kandidatë që vijnë nga radhët e gjyqësorit dhe tjetra me kandidatët që vijnë nga radhët e juristëve;
- U zgjerua përcaktimi organizmave për marrjen e opinioneve lidhur me kandidatët për anëtarë të GJK, duke u parashikuar se do të jenë “Institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë,”;
- Janë bërë disa rregullime lidhur me statusin e këshilltarëve ligjorë të GJK dhe trajtimin financiar të tyre;
- Për kërkesat që lidhen me kundërshtimin e akteve normative, (ankimi individual kushtetues i ri), zbatimi të hyjë në fuqi në datën 1 Mars 2017;
- Janë bërë edhe disa rregullime të karakterit teknik në projektligj.

7. EFEKTET FINANCIARE TË PROJEKTLIGJIT

Mbështetur në nenin 82 pikat 2 dhe 3 të Kushtetutës, dhe në nenin 68 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni kërkoi mendimin e Këshillit të Ministrave lidhur me efektet financiare të këtij projektligji.

8. PËRFUNDIM

Në përfundim të procesit të hartimit, konsultimit dhe diskutimit të këtij projektligji, Komisioni i Posaçëm Parlamentar "Për reformën në Sistemin e Drejtësisë" miratoi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”” dhe ia paraqet seancës plenare të Kuvendit për votim, sipas tekstit integral bashkëlidhur këtij raporti.

RELATORI

Pandeli MAJKO

KRYETARI

Fatmir XHAFAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ
Nr..... datë

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8577, DATË 10.02.2000 “PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E
GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të neneve 81, 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.8577, datë 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 1, pika 2, pas fjalëve “nga ky ligj” shtohen fjalët “apo nga Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese”.

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si më poshtë:

“Gjykata Kushtetuese zgjidh mosmarrëveshjet kushtetuese dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.”

Neni 3

Në nenin 5, pika 1, pas fjalëve “Flamuri Kombëtar dhe” shtohet fjala “stema”.

Neni 4

Titulli i Kreut II ndryshohet: “Emërimi, zgjedhja dhe mbarimi i mandatit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.”

Neni 5

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 7

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë anëtarë, prej të cilëve tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese emërohen për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.
2. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet, me një të tretën e saj. Anëtarët e rinj caktohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës, nga Kuvendi dhe nga Gjykata e Lartë. Ky rregull ndiqet edhe në rastet e përfundimit para afatit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.”

Neni 6

Pas nenit 7 shtohen nenet 7/a, 7/b, 7/c, 7/ç, 7/d, 7/dh, me këtë përmbajtje:

“Neni 7/a

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:
 - a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
 - b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
 - c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
 - ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
 - d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
 - dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.
2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriteret:
 - a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
 - b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.
3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:
- a) vjetërsisë në profesion;
 - b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;
 - c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
 - ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
 - d) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
 - dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.
4. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimin e barazisë gjinore.”

Neni 7/b

Procedura e emërimit nga Presidenti i Republikës

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, sipas këtij ligji, njofton për vendin vakant Presidentin e Republikës, i cili, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit, shpall në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a paraqiten pranë Presidentit të Republikës, i cili ia dërgon ato Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
2. Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, brenda 5 ditëve nga dita e publikimit të listës së kandidatëve, thërret mbledhjen e Këshillit që shqyrton plotësimin e kushteve dhe të kriterëve ligjore nga kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes është publik dhe përmban datën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes. Institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
3. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të kushteve dhe të kriterëve të emërimit, brenda 10 ditëve nga zhvillimi i mbledhjes harton një listë përfundimtare duke renditur kandidatët. Nëse ka më shumë se një vend vakant, Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit. Lista shoqërohet nga një raport me shkrim ku analizohet plotësimi i kushteve dhe kriterëve ligjore për secilin kandidat. Raporti i arsyetuar, pasi miratohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, publikohet.
4. Presidenti brenda 30 ditëve nga marrja e listës prej Këshillit të Emërimeve në Drejtësi emëron gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese nga kandidatët e renditur në tre vendet e para të listës. Dekreti i emërimit shpallet i shoqëruar me arsyet e përzgjedhjes së kandidatit. Nëse Presidenti nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar.

Neni 7/c
Procedura e zgjedhjes nga Kuvendi

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, sipas këtij ligji, njofton për vendin vakant Kuvendin, i cili, brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit, shpall në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Pranë Kuvendit paraqiten aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet që vërtetojnë përmbushjen e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në nenin 7/a të këtij ligji.
2. Kuvendi, brenda 30 ditëve nga hapja e procedurës së aplikimit, publikon listën e kandidatëve dhe ia dërgon ato Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
3. Brenda 5 ditëve nga dita e publikimit të listës së kandidatëve, Kryetari i Këshillit Emërimeve në Drejtësi thërret mbledhjen e Këshillit që shqyrton plotësimin e kushteve dhe të kritereve ligjore nga kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese. Njoftimi për thirrjen e mbledhjes është publik dhe përmban datën, orën dhe vendin e zhvillimit të mbledhjes. Dosjet e kandidatëve, me kërkesën dhe dokumentacionin përkatës, i vihen në dispozicion Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nga Kuvendi i Shqipërisë.
4. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kritereve të emërimit, brenda 10 ditëve harton një listë përfundimtare duke renditur kandidatët. Nëse ka më shumë se një vend vakant Këshilli harton dy lista të veçanta, një prej të cilave është me kandidatët që vijnë nga radhët e gjyqësorit. Lista shoqërohet nga një raport me shkrim, ku analizohet plotësimi i kushteve dhe kritereve ligjore për secilin kandidat. Raporti i arsyetuar, pasi miratohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, publikohet.
5. Komisioni i Ligjeve, sipas renditjes, brenda një afati të arsyeshëm, organizon seancat dëgjimore me kandidatët. Institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Pas këtyre seancave, Komisioni i dërgon Kuvendit emrat e tre kandidatëve për çdo vend vakant bashkë me raportin e arsyetuar për secilin kandidat të përzgjedhur.
6. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese zgjidhen me 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë konsiderohet i emëruar.
7. Nëse ka më shumë se një vend vakant njëkohësisht, të paktën një anëtar i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet nga kandidatët me arsim juridik, me jo më pak se 15 vjet eksperiencë në profesionin e avokatit, profesorit ose lektorit të së drejtës, juristit të lartë në administratën publike“

Neni 7/ç
Procedura e zgjedhjes nga Gjykata e Lartë

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, sipas këtij ligji, njofton për vendin vakant Kryetarin e Gjykatës së Lartë, i cili shpall në mjetet e informimit publik dhe në faqen zyrtare të internetit hapjen e procedurës së aplikimit. Kryetari i Gjykatës së Lartë pranon kandidaturat brenda 30 ditëve nga njoftimi, i bën ato publike dhe ia dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, pas vlerësimit të kushteve dhe kriterëve të emërimit, brenda 10 ditëve rendit kandidatët dhe i paraqet Kryetarit të Gjykatës së Lartë raportin e miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve, bashkë me listën dhe dokumentacionin shoqëruar, për çdo kandidat. Raporti i arsyetuar pasi miratohet me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, publikohet.

3. Kryetari i Gjykatës së Lartë thërret mbledhjen e posaçme të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Mbledhja është e vlefshme nëse marrin pjesë jo më pak se 3/4 e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Lista me kandidatët u bëhet e njohur më parë të gjithë pjesëmarrësve në mbledhje.

4. Për çdo vend vakant votohet për secilin nga kandidatët e renditur në tre vendet e para të listës. Kandidati që merr 3/5 e votave të gjyqtarëve të pranishëm shpallet i zgjedhur. Nëse nuk arrihet shumica e nevojshme, kandidati i renditur i pari nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konsiderohet i zgjedhur.

5. Emri i gjyqtarit të zgjedhur i njoftohet menjëherë Kryetarit të Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.”

Neni 7/d

Zgjedhja e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese zgjidhet me votim të fshehtë, me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, për një periudhë 3 vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

2. Seanca për zgjedhjen e Kryetarit drejtohet nga gjyqtari më i vjetër në detyrë. Në rast se ka më shumë se një kandidat dhe gjatë votimit asnjëri prej tyre nuk merr shumicën e parashikuar të votave, bëhet një votim i ri dhe, pas këtij, vijohet me votimin mes kandidatëve që kanë marrë numrin më të madh të votave. Në përfundim të këtij votimi shpallet i zgjedhur kandidati që ka marrë shumicën e votave. Në rast se asnjë nga kandidatët nuk ka marrë shumicën e votave ose votat janë ndarë në mënyrë të barabartë, kryetari caktohet me short. Procedura e zhvillimit të shortit parashikohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve.

3. Kryetari i zgjedhur njofton Presidentin e Republikës dhe Kryetarin e Kuvendit.“

Neni 7/dh

Përtëritja e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese

1. Përbërja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese përtërihet rregullisht çdo 3 vjet, me një të tretën e saj.

3. Në rast të përfundimit të mandatit të gjyqtarit para afatit, zgjedhja e gjyqtarit të ri i cili qëndron në detyrë deri në përfundimin e mandatit të gjyqtarit të larguar, ndjek radhën e parashikuar për zëvendësimin e tij, sipas nenit 7, pika 2 të këtij ligji.”

Neni 7

Në nenin 8, pika 3, pas fjalëve “datën e njëjtë të atij muaji,” shtohen fjalët “të vitit të nëntë”.

Neni 8

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9 Mbarimi i mandatit

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mbaron në rastet e mëposhtme:
 - a) mbush moshën 70 vjeç;
 - b) përfundon mandatin 9 vjeçar;
 - c) jep dorëheqjen;
 - ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 128 të Kushtetutës;
 - d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit;
 - dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.
2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit deklarohet me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Kërkesa për deklarimin e mbarimit të mandatit të gjyqtarit bëhet nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese.
3. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës 1, shkronjat a) dhe b), të këtij neni, si dhe menjëherë në rastet e mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor, njofton organin e emërtesës për vendin vakant. Procedura për emërimin e gjyqtarit të ri përfundon jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka deklaruar përfundimin e mandatit.
4. Në çdo rast të mbarimit të mandatit të gjyqtarit vihet në dijeni Presidenti i Republikës dhe Kuvendi i Shqipërisë.”

Neni 9

Pas Kreut II shtohet Kreu II/1 me titull “Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese”.

Neni 10

Neni 10 ndryshohet si më poshtë :

“Neni 10 Shkeljet disiplinore

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mban përgjegjësi disiplinore, veçanërisht për shkaqe të:

1. mosparaqitjes së kërkesës për heqje dorë nga procedimi apo gjykimi i çështjes, kur kjo është e detyrueshme, sipas ligjit procedural dhe gjyqtari është në dijeni të rrethanave të tilla;
2. sjelljes, akteve dhe veprimeve të tjera të gjyqtarit që krijojnë përfitime të padrejta ose dëme për palët pjesëmarrëse në gjykim;

3. mosnjoftimit të Kryetarit të Gjykatës ose të organeve kompetente sipas ligjit, për ndërhyrjet apo ushtrimin e formave të tjera të ndikimit të papërshtatshëm nga avokatët, funksionarët politikë, funksionarët publikë dhe subjekte të tjerë;
4. ndërhyrjeve ose çdo lloj ndikimi tjetër të papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës të një gjyqtari tjetër;
5. mosnjoftimit të Kryetarit dhe të institucioneve përgjegjëse për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të rasteve të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit të tij;
6. mospërbushjes së pajustificuar e në mënyrë të qëllimshme ose të përsëritur, përkatësisht të funksionit të tij;
7. paraqitjes së kërkesës për heqje dorë dhe kryerjes së atyre veprimeve që nuk bazohen në shkaqet e parashikuara në ligj ose që bëhen në mënyrë të qëllimshme për të krijuar përfitime të padrejta për palët dhe të tretët, ose kur synojnë të shmangin gjyqtarin nga detyrimi ligjor për shqyrtimin e çështjes ose synojnë të krijojnë mundësinë e shqyrtimit të saj nga gjyqtarët të tjerë ose kur dorëheqja jepet e vonuar megjithëse ka qenë në dijeni të faktit për të cilin jep dorëheqjen;
8. shkeljes së përsëritur ose të rëndë të rregullave të solemnitetit dhe rregullave të sjelljes në marrëdhëniet me pjesëmarrësit në proces, si edhe me gjyqtarë ose administratën e Gjykatës Kushtetuese;
9. vonesës dhe zvarritjes së përsëritur dhe të pajustificuar të veprimeve procedurale dhe gjatë ushtrimit të funksionit;
10. bërjes publike të mendimeve që ka dhënë vetë ose gjyqtarët e tjerë gjatë procesit që akoma nuk kanë marrë formën e një akti të bërë publik;
11. shkeljes së detyrimit të konfidencialitetit dhe të mospërhapjes së informacionit, që rezultojnë nga hetimi ose gjykimi, në proces apo i përfunduar, duke përfshirë lehtësinë e publikimit dhe shpërndarjes, gjithashtu edhe për shkak të neglizhencës, të akteve konfidenciale ose akteve procedurale ose informacioneve konfidenciale që rrjedhin nga çështjet të cilat janë në proces hetim ose gjykimi;
12. bërjes së deklaratave publike dhe në media, për çështjet, me përjashtim të komunikimeve të shtypit brenda kufijve të detyrës së tij;
13. parashtrimi të shtrembëruar të fakteve në aktet e nxjerra;
14. përdorimit të mandatit të gjyqtarit me qëllim për të realizuar përfitime të pajustificuara ose përfitime për vete ose për të tjerët;
15. shoqërimit me persona që janë nën ndjekje penale ose janë subjekte të një procedimi penal, ose me persona të dënuar penalisht, përveç rasteve të rehabilitimit të personave të dënuar, ose persona të cilët janë të afërm me gjyqtarët në lidhje gjaku ose me ligj, dhe pasja e marrëdhënieve biznesi të papërshtatshme me këta persona;
16. përfitimit të padrejtë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të çfarëdo lloji, të cilat, qoftë edhe me anë të veprimeve të ligjshme, i jepen për shkak të funksionit që ushtron ose si rrjedhojë e përdorimit prej tij të pozicionit të magjistratit;
17. sjelljes së papërshtatshme në përmbushjen e detyrimeve, në marrëdhëniet dhe në komunikimin me institucionet shtetërore dhe funksionarët e tyre, dhe raste të tjera me sjellje të papërshtatshme të pajustificuar.”

Neni 11

Pas nenit 10, shtohen nenet 10/a, 10/b, 10/c, 10/ç, me këtë përmbajtje:

“Neni 10/a

Fillimi dhe zhvillimi i procedimit disiplinor

1. Kur ka të dhëna të mjaftueshme se një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese ka kryer shkelje të parashikuara në nenin 128 të Kushtetutës dhe në nenin 10 të këtij ligji, me kërkesë të Kryetarit ose të çdo gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, Kryetari, ose gjyqtari më i vjetër në detyrë, kur subjekt i procedimit është Kryetari, merr masat për fillimin e procedimit disiplinor.
2. Procedimi disiplinor fillon menjëherë nga momenti i konstatimit të shkeljes. Procedimi disiplinor pushon nëse gjyqtari jep dorëheqjen. Në këtë rast ai nuk ka të drejtë të emërohet më në funksione publike për një periudhë 15 vjeçare.
3. Dy gjyqtarë të caktuar me short mbledhin fakte, prova dhe të dhëna të tjera lidhur me shkeljen që i atribuohet gjyqtarit dhe brenda 30 ditëve përgatisin relacionin përkatës dhe ia dërgojnë atë për shqyrtim Komisionit Disiplinor.
4. Komisioni Disiplinor përbëhet nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të caktuar me short, pa pjesëmarrjen e gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në mbledhjen e fakteve dhe provave sipas pikës 3 të këtij neni. Komisioni merr në shqyrtim relacionin e paraqitur dhe vendos dhënien e masës disiplinore sipas nenit 10/b të këtij ligji ose pushimin e çështjes për shkak se nuk provohet shkelja.
5. Gjyqtari, subjekt i procedimit, ka të drejtë të ushtrojë ankim ndaj vendimit të Komisionit Disiplinor. Ankimi shqyrtohet nga komisioni *ad hoc* i përbërë nga tre gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, që nuk kanë marrë pjesë në procedim sipas pikës 3 dhe 4 të këtij neni.

Neni 10/b

Masat disiplinore

1. Ndaj gjyqtarit mund të vendosen këto masa disiplinore:
 - a) vërejtje me shkrim;
 - b) vërejtje publike;
 - c) ulje e përkohshme e pagës deri në 50% për një periudhë jo më të gjatë se 1 vit;
 - ç) pezullim nga detyra për një periudhë nga 3 muaj deri në 6 muaj;
 - d) shkarkim nga detyra.
2. Gjatë kohës së procedimit disiplinor, gjyqtari pezullohet nga detyra, sipas nenit 10/ç të këtij ligji dhe përfiton 50% të pagës së tij.”

Neni 10/c

Shqyrtimi i shkeljes disiplinore

1. Komisioni Disiplinor shqyrton çështjen brenda 10 ditëve nga paraqitja e relacionit dhe vendos:
 - a) Dhënien e masës disiplinore;
 - b) Rrëzimin e propozimit për masë disiplinore;
 - c) Kthimin e çështjes për mbledhje të provave dhe fakteve të tjera;

c) Pushimin e çështjes, kur gjyqtari jep dorëheqjen nga detyra, ose i mbaron mandati.
2. Vendimi i njoftohet gjyqtarit të proceduar dhe në çdo rast publikohet. Kur ndaj gjyqtarit të proceduar vendoset shkarkimi nga detyra, vendimi i dërgohet organit të emërtesës.”

Neni 10/ç Pezullimi i gjyqtarit nga detyra

1. Gjyqtari pezullohet nga detyra me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve kur:
 - a) ndaj tij caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” ose “arrest në shtëpi”;
 - b) merr cilësinë e të pandehurit;
 - c) fillon procedimi disiplinor, sipas këtij ligji.
2. Kryetari ose gjyqtari më i vjetër në detyrë, kur subjekt procedimi është Kryetari, brenda tre ditëve nga marrja dijani e shkaqeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, thërret Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila vendos për masën e pezullimit ndaj gjyqtarit. Vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve është përfundimtar.
3. Gjyqtari i pezulluar nuk merr pjesë në shqyrtimin e çështjeve deri në heqjen e masës së pezullimit nga Mbledhja e Gjyqtarëve.
4. Kryetari merr masa për caktimin e një relatori të ri për çështjet e caktuara gjyqtarit të pezulluar.”

Neni 12

Neni 11 shfuqizohet.

Neni 13

Pas Kreut II/1 shtohet Kreu II/2 me titull “Organizimi i Gjykatës Kushtetuese”.

Neni 14

Neni 12 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 12 Kompetencat e Kryetarit

1. Veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese drejtohet dhe organizohet nga Kryetari i saj dhe, në mungesë të tij, nga gjyqtari më i vjetër në detyrë, me përjashtim të rasteve kur çështja është në kompetencë të Mbledhjes së Gjyqtarëve.
2. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ka këto kompetenca:
 - a) Përgatit, thërret e drejton seancat plenare të Gjykatës Kushtetuese;
 - b) Përfaqëson Gjykatën Kushtetuese në marrëdhënie me të tretët;
 - c) Bashkërendon punën midis gjyqtarëve;
 - ç) Nënshkruan aktet e Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të vendimeve që nënshkruhen nga të gjithë gjyqtarët;

d) Emëron dhe largon nga detyra personelin administrativ, si dhe merr masa disiplinore ndaj tij.”

Neni 15

Neni 13 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 13 Kompetencat e Mbledhjes së Gjyqtarëve

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka këto kompetenca:

- a) Përcakton drejtimet kryesore të shpenzimeve të mjeteve buxhetore;
- b) Informohet çdo 6 muaj me raporte për shpenzimet buxhetore;
- c) Vendos për strukturën organizative të Gjykatës Kushtetuese;
- ç) Vendos për numrin e nëpunësve të administratës, të Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe punonjësve të tjerë, si dhe kriteret profesionale që duhet të përmbushin dhe pagat e tyre;
- d) Miraton rregulloren për procedurat gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese si dhe rregulloren e brendshme për veprimtarinë e administratës së Gjykatës Kushtetuese;
- dh) Emëron dhe shkarkon Sekretarin e Përgjithshëm;
- e) Cakton kolegjet në fillim të çdo viti kalendarik, sipas Rregullores së Gjykatës Kushtetuese;
- ë) Shqyrton në shkallë të fundit ankimet e nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë për largimin nga detyra;
- f) Vendos për masat disiplinore ndaj këshilltarëve ligjorë.”

Neni 16

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 14 Administrata e Gjykatës Kushtetuese

1. Administrata e Gjykatës përbëhet nga nëpunësit civilë dhe punonjës të tjerë. Në ushtrimin e funksioneve të tij Kryetari asistohet nga Kabineti.
2. Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil dhe emërohet nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me propozim të Kryetarit, nga radhët e juristëve me përvojë profesionale jo më pak se 10 vjet.
3. Ai shkarkohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve, me propozim të një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, sipas rregullave të parashikuara nga Mbledhja e Gjyqtarëve për këtë qëllim.
4. Sekretari i Përgjithshëm, nën autoritetin dhe sipas udhëzimeve të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, drejton veprimtarinë administrative të Gjykatës Kushtetuese.
4. Nëpunësit civilë të administratës së Gjykatës Kushtetuese i nënshtrohen rregullave të shërbimit civil për aq sa nuk bien ndesh me këtë ligj dhe trajtohen financiarisht njëjloj si administrata e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
5. Të drejtat dhe detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm, nëpunësve civilë dhe të punonjësve të tjerë përcaktohen nga ky ligj dhe Rregullorja e Brendshme.”

Neni 17

Pas nenit 14 shtohet neni 14/a me këtë përmbajtje:

“Neni 14/a Njësia e Shërbimit Ligjor

1. Pranë Gjykatës Kushtetuese funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor, e cila përbën bërthamën shkencore juridike të Gjykatës Kushtetuese. Ajo ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese duke përfshirë: përgatitjen e çështjeve për gjykim, dhënien e opinioneve ligjore dhe përgatitjen e kërkimeve shkencore për çështjet gjyqësore që janë për shqyrtim para Gjykatës Kushtetuese, si dhe çdo detyrë tjetër që i caktohet nga Kryetari ose Mbledhja e Gjyqtarëve.
2. Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarë ligjorë, të cilët emërohen nga Kryetari, nga radhët e juristëve që plotësojnë kriteret për të qenë gjyqtarë, prokurorë ose juristë me përvojë jo më pak se 10 vjet si lektorë të së drejtës, avokatë ose nëpunës të lartë të administratës publike. Jo më pak se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë emërohen nga radhët e magistratëve. Këshilltari ligjor që vjen nga radhët e juristëve përfiton pagë të barabartë me pagën e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, pa shtesat për vjetërsinë.
3. Njësia e Shërbimit Ligjor është në varësi të Kryetarit, i cili për çdo çështje gjyqësore cakton këshilltarin ligjor, duke marrë për bazë përvojën profesionale dhe ekspertizën ligjore të tij, sipas Rregullores së Gjykatës Kushtetuese. Numri i këshilltarëve ligjorë caktohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve.
4. Këshilltarët ligjorë mbajnë përgjegjësi disiplinore. Masat disiplinore vendosen nga Mbledhja e Gjyqtarëve, sipas Rregullores.
5. Këshilltarët ligjorë i nënshtrohen rregullave të parashikuara në këtë ligj, Rregullores së Brendshme të Gjykatës Kushtetuese dhe ligjit për statusin e magistratit, për aq sa ai gjen zbatim.”

Neni 18

Neni 16 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 16 Imuniteti

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij, përveç rasteve të dhënies qëllimisht të një vendimi si pasojë e një interesi personal ose keqdashje.”

Neni 19

Pas nenit 16 shtohet neni 16/a me këtë përmbajtje:

“Neni 16/a
Papajtueshmëria

1. Qenia gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik dhe shkencor për zhvillimin e doktrinës. Kohëzgjatja e veprimtarisë profesionale të lejueshme parashikohet me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit nuk pajtohet me qenien anëtar në një parti politike apo pjesëmarrjen në aktivitete publike të organizuara nga një parti politike, si dhe me veprimtari të tjera të papajtueshme me detyrën e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese.
2. Gjyqtari i sapozgjedhur merr masat për shmangien e çdo situatë papajtueshmërie brenda 10 ditëve nga betimi.
3. Në rast se anëtari i Gjykatës Kushtetuese gjatë ushtrimit të detyrës ndodhet në një situatë papajtueshmërie, ai menjëherë merr masa për shmangien e saj. Në rast të kundërt, gjejnë zbatim rregullimet e nenit 10 e në vijim të këtij ligji.”

Neni 20

Në nenin 21, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Shqyrtimi i çështjeve nga Gjykata Kushtetuese bëhet në seancë plenare publike ose mbi bazë të dokumenteve. Në çdo rast vendos Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve.”

Neni 21

Në nenin 22, pika 2, pas fjalëve “nga Gjykata Kushtetuese,” shtohen fjalët “me kërkesë të palës”.

Neni 22

Neni 23 shfuqizohet.

Neni 23

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24
Mbrojtja në gjykimin kushtetues

Pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues mbrohen vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor. Kur çështja kalon për gjykim dhe objekt kërkesë është një ligj ose akt normativ kërkuesi përfaqësohet në gjykim me avokat ose përfaqësues ligjor të specializuar.”

Neni 24

Në nenin 25 titulli ndryshohet si më poshtë:
“Paanshmëria në gjykimin kushtetues”.

Neni 25

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Publikimi i vendimit përfundimtar dhe hyrja e tij në fuqi

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese publikohen në Fletoren Zyrtare, si dhe në mjete të tjera të informimit publik. Publikimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese bëhet jo më vonë se 15 ditë nga depozitimi i tyre për këtë qëllim në Qendrën e Botimeve Zyrtare. Mendimi i pakicës publikohet bashkë me vendimin përfundimtar.
2. Vendimet, si rregull, hyjnë në fuqi ditën e publikimit, përveçse kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj. Kur vendimi sjell pasoja për të drejtat kushtetuese të individit, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që ai të hyjë në fuqi ditën e shpalljes së tij. Në këtë rast, vendimi shoqërohet me një arsyetim të përmbledhur, ndërsa vendimi i arsyetuar plotësisht publikohet brenda 30 ditëve.
3. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë pezullimin e zbatimit të aktit të shfuqizuar prej saj ndaj kërkuesit në çështjen gjyqësore deri në kohën kur vendimi fillon efektet.
4. Gjykata Kushtetuese përgatit dhe publikon përmbledhje periodike të vendimeve të saj.”

Neni 26

Neni 27 ndryshohet si më poshtë :

“Neni 27

Përmbajtja e kërkesës

1. Kërkesa në Gjykatën Kushtetuese paraqitet nga kërkuesi ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij. Në rast se kërkuesi ka zgjedhur të përfaqësohet nga një avokat, ai i bashkëngjit kërkesës aktin e përfaqësimit. Në një rast të tillë të gjitha njoftimet e Gjykatës i drejtohen përfaqësuesit të kërkuesit.
2. Kërkesa paraqitet në formë të shkruar në gjuhën shqipe, qartë e kuptueshëm, në aq kopje sa janë pjesëmarrësit në gjykim dhe duhet të përmbajë:
 - a) emrin dhe adresën e Gjykatës Kushtetuese;
 - b) emrin, mbiemrin ose emërtimin, vendbanimin ose vendqëndrimin e kërkuesit dhe/ose të përfaqësuesit;
 - c) emrin, mbiemrin ose emërtimin, vendbanimin ose vendqëndrimin e subjekteve të interesuara dhe ose të përfaqësuesve;
 - ç) objektin e kërkesës dhe bazën ligjore;
 - d) parashtrimin e shkaqeve dhe shkeljet e natyrës kushtetuese të pretenduara;
 - dh) dokumentet, provat, apo materiale të tjera që shoqërojnë kërkesën;

e) kopje të noterizuara të të gjitha vendimeve objekt kërkesë, si dhe të ankimeve dhe rekurseve të paraqitura në instancat e tjera gjyqësore;

ë) nënshkrimin e kërkuarit ose të përfaqësuesit të tij, si dhe aktin e përfaqësimit të këtij të fundit.

3. Kërkesa mund të paraqitet dorazi ose me postë. Në rast të dërgimit të kërkesës me postë, data e paraqitjes së saj konsiderohet data e dorëzimit në zyrën postare. Në rast se kërkesa është dërguar gabimisht në një institucion tjetër dhe kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese pas përfundimit të afatit ligjor, kërkesa konsiderohet e paraqitur në afat në rast se provohet se kjo ka ndodhur në mirëbesim.

4. Kërkesa që plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2 të këtij neni regjistrohet në regjistrin e posaçëm që mbahet nga Drejtoria Gjyqësore pranë Gjykatës Kushtetuese.

5. Kërkesa që nuk plotëson kriteret e parashikuara në pikën 2 të këtij neni konsiderohet e paplotë dhe nuk regjistrohet në regjistrin e kërkesave. Drejtoria Gjyqësore njofton kërkuarin që brenda 10 ditëve të bëjë plotësimet e nevojshme. Në rast se kërkuari nuk e paraqet kërkesën të plotësuar ose brenda afatit të caktuar nga Drejtoria Gjyqësore, kërkesa arkivohet.

6. Kërkesa e regjistruar në regjistrin e kërkesave i dorëzohet Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, i cili merr masat për caktimin me short të relatorit të çështjes, sipas Rregullores së Gjykatës.”

Neni 27

Neni 28 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 28 Shpenzimet gjyqësore

1. Shpenzimet e procesit gjyqësor para Gjykatës Kushtetuese i nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifat gjyqësore.

2. Kur Gjykata Kushtetuese vendos pranimin e ankimit individual kushtetues, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuari.”

Neni 28

Neni 29 shfuqizohet.

Neni 29

Neni 30 shfuqizohet.

Neni 30

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31 Shqyrtimi paraprak i kërkesës

1. Kërkesa shqyrtohet paraprakisht nga kolegji i përbërë nga tre gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori.
2. Kur kërkesa, megjithëse është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese dhe është paraqitur nga subjekti që legjitimohet, nuk është e plotë për ndonjë shkak të ndryshëm nga ata që parashikohen në nenin 27 të këtij ligji, Kolegji ia kthen kërkesit për plotësim, duke dhënë shkaqet e kthimit dhe afatin e plotësimit të saj. Kur kërkesa paraqitet e plotësuar brenda afatit të përcaktuar për korrigjimin e të metave, kalon përsëri për shqyrtim paraprak në kolegji. Në këtë rast si datë e paraqitjes së kërkesës konsiderohet data e paraqitjes së saj për herë të parë në Gjykatë. Në rast se kërkesa paraqitet në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar për korrigjimin e të metave, por e paplotësuar, Kolegji vendos moskalimin për gjykim.
3. Kur kërkesa nuk përmbush kriteret e parashikuara në nenin 31/a pika 2 të këtij ligji, kolegji vendos moskalimin e çështjes në seancë plenare. Në të gjitha rastet, kur ndonjë nga gjyqtarët e kolegjit nuk është i një mendimi me të tjerët, kërkesa i kalon për shqyrtim paraprak Mbledhjes së Gjyqtarëve.
4. Kolegji ose Mbledhja e Gjyqtarëve nuk shqyrton themelin e çështjes në këtë fazë.
5. Ankesat, lutjet dhe çdo korrespondencë tjetër që nuk përmban elementët e kërkesës sipas nenit 27 të këtij ligji, regjistrohen në regjistër të veçantë dhe për to veprohet administrativisht.”

Neni 31

Pas nenit 31 shtohen nenet 31/a, 31/b, 31/c, me këtë përmbajtje:

“Neni 31/a

Moskalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare

1. Vendimi për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare nga Kolegji merret njëzëri, ndërsa nga Mbledhja e Gjyqtarëve merret me shumicën e votave.
2. Moskalimi i çështjes në seancë plenare vendoset kur:
 - a) kërkimet e paraqitura në kërkesë nuk hyjnë në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese;
 - b) kërkesa nuk është paraqitur nga subjekti që legjitimohet;
 - c) kërkesa është paraqitur nga një person i paautorizuar;
 - ç) vërtetohet se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor;
 - d) kërkesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, ose legjislacioni në fuqi parashikon mjete efektive në dispozicion;
 - dh) kërkimet e paraqitura në kërkesë janë objekt i një vendimi të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese, ose rivendosja në vend e të drejtës së shkelur nuk është e mundur;
 - e) kërkesa është haptazi e pabazuar.

Neni 31/b

Heqja dorë nga kërkesa

1. Kërkesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjykimit të çështjes.

2. Gjkata Kushtetuese vendos mospranimin e heqjes dorë nga kërkesa kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik. Në këtë rast Gjkata Kushtetuese arsyeton vendimin për mospranimin e heqjes dorë.

Neni 31/c

Abuzimi me të drejtën për të paraqitur kërkesë

1. Gjkata Kushtetuese, kur konstaton se kërkuuesi ose përfaqësuesi i tij ligjor paraqet kërkesë abuzive ose të përsëritur, për të njëjtin shkak dhe objekt, megjithëse ajo është shqyrtuar një herë nga Gjkata Kushtetuese, ose kur konstatohet se kërkuuesi ose përfaqësuesi ligjor kanë fshehur ose shtrembëruar fakte dhe rrethana që lidhen me çështjen, urdhëron gjybitjen e tij në shumën nga 100.000-500.000 Lekë. Kur Gjkata konstaton se ndodhet përpara rasteve të falsifikimit të dokumenteve ose ndonjë veprë tjetër penale, ajo njëkohësisht ia dërgon materialet për hetim prokurorisë.
2. Vendimi në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni merret nga Mbledhja e Gjyqtarëve, me propozim të Kryetarit ose të relatorit të çështjes.
3. Gjyba e vendosur nga Mbledhja e Gjyqtarëve është titull ekzekutiv.”

Neni 32

Neni 32 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 32

Shqyrtimi në seancë plenare

1. Gjkata Kushtetuese shqyrton çështjet në seancë plenare me pjesëmarrjen e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë rast të jo më pak se të dy të tretave të tyre.
2. Rregullat mbi seancën plenare të zhvilluar me dyer të mbyllura caktohen me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve.
3. Gjatë zhvillimit të seancës respektohen rregullat e solemnitetit dhe të sigurisë, të cilat përcaktohen në Rregulloren e Gjykatës.
4. Regjistrimet radiofonike, televizive, audio ose video nga përfaqësues të medias gjatë seancës plenare lejohen vetëm me pëlqimin e Gjykatës, në varësi të çështjes konkrete.”

Neni 33

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

Thirrja dhe drejtimi i seancës plenare

1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese thërret dhe drejton seancën plenare të Gjykatës Kushtetuese. Nëse Kryetari është në pamundësi për të marrë pjesë në gjykim, ai cakton gjyqtarin më të vjetër në detyrë për të kryesuar seancën.
2. Kryesuesi i seancës plenare ushtron këto detyra:
 - a) merr masa për hetimin e plotë dhe të paanshëm të rrethanave të çështjes;

b) orienton diskutimet mes palëve dhe shmang çdo debat të panevojshëm për çështjen;
c) ndërpret palët pjesëmarrëse kur diskutimi i tyre nuk ka lidhje me çështjen ose nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese;

ç) u heq të drejtën e fjalës palëve nëse diskutimi i tyre është arbitrar, fytes dhe në kundërshtim me rregullat e etikës dhe moralit.

3. Kryesuesi i seancës mund të urdhërojë largimin e personave nga salla kur pjesëmarrësit në gjykim nuk zbatojnë urdhërimet e kryesuesit të seancës, si dhe kur nuk tregojnë respekt për trupin gjykues dhe Kushtetutën.

4. Seanca, si rregull zhvillohet pa ndërprerje. Në raste të veçanta, kryesuesi i seancës, pas marrjes së mendimit të anëtarëve të trupit gjykues, mund të ndërpresë seancën kur është e nevojshme.”

Neni 34

Neni 36 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 36

Heqja dorë nga shqyrtimi i çështjes

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese kërkon heqjen dorë nga shqyrtimi i një çështjeje konkrete kur:
 - a) ka marrë pjesë në hartimin e aktit objekt shqyrtimi;
 - b) ka deklaruar publikisht qëndrimin e tij ndaj çështjes;
 - c) për shkak të lidhjeve fisnore apo lidhjeve të tjera me pjesëmarrësit në gjykim vihet në dyshim paanshmëria e tij;
 - ç) paanshmëria e tij vihet në dyshim për shkaqe të tjera.
2. Kur objekt shqyrtimi është një ligj ose akt normativ, i cili mund të ketë efekte edhe për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese, heqja dorë e tij ose kërkesa për përjashtim për këtë shkak nuk pranohet.
3. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, gjyqtari, brenda një afati të arsyeshëm, i paraqet me shkrim kërkesën për heqjen dorë nga çështja Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese. Kërkesa për heqje dorë ose për përjashtimin nga gjykimi shqyrtohet menjëherë nga Mbledhja e Gjyqtarëve, e cila vendos për pranimin ose jo të saj.”

Neni 35

Neni 38 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 38

Njoftimi, paraqitja e dokumenteve dhe pjesëmarrja në seancë plenare

1. Njoftimi për orën dhe datën e zhvillimit të seancës plenare, publike ose mbi bazë të dokumenteve, bëhet nga Drejtoria Gjyqësore, si rregull, 30 ditë para datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare, me përjashtim të rasteve kur Gjykata Kushtetuese vendos ndryshe.
2. Njoftimi i kërkesit, subjektit të interesuar ose përfaqësuesit të tyre, ose sipas rastit i dëshmitarit, ekspertit apo personave të tjerë pjesëmarrja e të cilëve është e nevojshme për zhvillimin efektiv të gjykimit kushtetues, bëhet me shkresë zyrtare, me fletë-thirrje postare, me

telegram si dhe përmes e-mailit nëse palët kanë rënë dakord për këtë mënyrë njoftimi në momentin e depozitimit të kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese.

3. Kur ndonjëri nga pjesëmarrësit në gjykimin kushtetues nuk ka një vendqëndrim të saktë ose ndodhet me qëndrim të përhershëm jashtë shtetit, njoftimi bëhet me letërporosi, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile dhe me shpallje në selinë e Gjykatës Kushtetuese, të paktën 30 ditë përpara datës së caktuar për zhvillimin e seancës plenare.

4. Mosnjoftimi i rregullt shkakton shtyrjen e seancës plenare, duke caktuar një datë tjetër për zhvillimin e saj, si dhe duke bërë njoftimet përkatëse.

5. Kur kërkuesi, subjekti i interesuar ose përfaqësuesit e tyre, megjithëse janë njoftuar, nuk paraqiten në seancë plenare ose nuk dërgojnë dokumente shtesë, seanca plenare zhvillohet në mungesë.

6. Kur seanca zhvillohet mbi bazë dokumentesh mosparaqitja brenda afatit të përcaktuar dhe pa shkaqe të përligjura e parashtrimeve nga kërkuesi dhe e prapësimeve nga subjekti/et e interesuara pasjell zhvillimin e gjykimit vetëm mbi bazën e kërkesës dhe/ose dokumenteve shoqëruese të saj të paraqitura në momentin e regjistrimit.”

Neni 36

Në nenin 42 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Ndryshohet titulli i nenit si më poshtë:

“Kërkimi i dokumenteve dhe detyrimi për t’i paraqitur ato”;

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Çdo organ shtetëror, person fizik ose juridik, ka detyrimin t’i vërë në dispozicion Gjykatës Kushtetuese dokumente, të dhëna e njoftime kur këto kërkohen e çmohen të nevojshme për shqyrtimin e çështjes.”

Neni 37

Pas nenit 43 shtohen nenet 43/a dhe 43/b, me këtë përmbajtje:

“Neni 43/a

Procedura gjatë zhvillimit të seancës publike

1. Personat e pranishëm në sallën e gjyqit duhet të respektojnë solemnitetin e Gjykatës. Ata duhet t’i binden kërkesave të Kryesuesit të seancës për mbajtjen e qetësisë.

2. Mbarëvajtja e seancës gjyqësore garantohet nga një punonjës i Gjykatës. Kërkesat e tij për ruajtjen e rendit ose për zbatimin e udhëzimeve të Kryesuesit të seancës janë të detyrueshme për të gjithë pjesëmarrësit në proces.

Neni 43/b

Të drejtat e pjesëmarrësve në seancë gjyqësore

1. Pjesëmarrësit në procesin e gjykimit para Gjykatës Kushtetuese kanë këto të drejta:

a) të njihen me dokumentet e dosjes, të marrin ekstrakte ose fotokopje të tyre;

b) të marrin pjesë në shqyrtimin e provave;

- c) të paraqesin prova;
 - ç) t'i drejtojnë pyetje njëri-tjetrit, dëshmitarëve, ekspertëve e specialistëve;
 - d) të paraqesin kërkesa;
 - dh) të japin shpjegime me shkrim ose me gojë;
 - e) të paraqesin përfundimet e tyre;
 - ë) të kundërshtojnë kërkesat e palëve të tjera, përfundimet dhe shpjegimet e tyre, si dhe të paraqesin pretendime përfundimtare.
2. Kërkuesi, në çdo fazë të procesit deri në marrjen e vendimit nga Gjykata Kushtetuese, mund të kërkojë më shkrim pakësimin dhe shtimin e objektit të kërimit ose heqjen dorë nga kërkesa.”

Neni 38

Pas nenit 44 shtohen nenet 44/a dhe 44/b, me këtë përmbajtje:

“Neni 44/a
Shtyrja e seancës

Gjykata mund të shtyjë shqyrtimin e çështjes nëse ajo e vlerëson të nevojshme paraqitjen e dëshmitarëve dhe të ekspertëve të fushës, marrjen e provave të tjera, hetimin e mëtejshëm të çështjes ose formimin e plotë të trupit gjykues. Shqyrtimi i çështjes rifillon nga momenti i ndërprerjes.”

Neni 44/b
Pezullimi i gjykimit

1. Nëse Gjykata Kushtetuese gjatë shqyrtimit të çështjes vendos të kërkojë një opinion këshillimor nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut lidhur me zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe protokolleve shtesë të saj ose të kërkojë *amicus curia* nga organizma të tjerë, ajo vendos pezullimin e shqyrtimit të çështjes.
2. Seanca rihapet menjëherë pas marrjes së opinionit këshillimor nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ose *amicus curia*. Opinioni i marrë u njoftohet palëve bashkë me datën e seancës.”

Neni 39

Në nenin 45 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Ndryshohet titulli i nenit si më poshtë:
“Pezullimi i ligjit ose aktit”;
2. Pas pikës 4, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:
“5. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese në çdo rast jepet i arsyetuar dhe publikohet menjëherë.”

Neni 40

Neni 46 shfuqizohet.

Neni 41

Neni 47 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 47

Afati i shqyrtimit të çështjes

1. Shqyrtimi i çështjeve nga Kolegjet ose Mbledhja e Gjyqtarëve përfundon brenda tre muajve nga paraqitja e kërkesës, me përjashtim të rasteve kur ky ligj përcakton afate të tjera. Në çdo rast bisedimet dhe marrja e vendimit nga Kolegjet ose Mbledhja e Gjyqtarëve bëhet mbi bazën e projektvendimit të përgatitur nga relatori.
2. Shqyrtimi i çështjes në seancë plenare bëhet pasi të jenë depozituar paraprakisht nga palët të gjitha materialet e nevojshme për gjykim, si dhe çështja të jetë përgatitur në tërësi nga relatori i çështjes. Relatori i çështjes paraqet në bisedime projektvendimin përkatës, mbi të cilin votojnë të gjithë gjyqtarët që kanë marrë pjesë në votim.
3. Vendimi përfundimtar shpallet i arsyetuar jo më vonë se 30 ditë nga përfundimi i seancës, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.”

Neni 42

Neni 49 ndryshohet si më poshtë :

“Neni 49

Subjektet që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese

1. Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare e kanë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, jo më pak se një e pesta e deputetëve dhe Avokati i Popullit.
2. Të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për kontrollin vetëm të respektimit të procedurës së parashikuar nga Kushtetuta, sipas nenit 177 dhe nenit 131, pika 2, të Kushtetutës e kanë Presidenti i Republikës dhe jo më pak se një e pesta e deputetëve.
3. Të drejtën për të filluar një kontroll mbi pajtueshmërinë e ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare e kanë edhe:
 - a) Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;
 - b) organet e qeverisjes vendore, kur pretendojnë se u janë cenuar të drejtat e tyre të parashikuara në Kushtetutë ose pozita e tyre kushtetuese;
 - c) komisionerët e krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut, kur gjatë veprimtarisë së tyre konstatojnë se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve;
 - ç) Këshilli i Lartë Gjyqësor ose Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë kushtetuese të tyre ose pozitën juridike të gjyqtarëve dhe të prokurorëve;
 - d) organet e bashkësive fetare, partitë politike, organizatat, kur pretendojnë se ligji ose akti normativ cenon veprimtarinë e tyre dhe të drejtat dhe liritë e anëtarëve të tyre;

- dh) gjykatat e të gjitha niveleve, kur gjatë gjykimit të një çështjeje konstatojnë se ligji ose akti normativ bie ndesh me Kushtetutën ose marrëveshjet ndërkombëtare;
- e) individët, kur pretendojnë se u cenohen në mënyrë të drejtpërdrejt dhe reale të drejtat dhe liritë e tyre të parashikuara në Kushtetutë, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për këtë qëllim, si dhe kur akti që kundërshtojnë është drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e tij.
4. Subjektet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni kanë detyrimin të provojnë në çdo rast se çështja lidhet drejtpërdrejt me të drejtat dhe liritë e parashikuara nga Kushtetuta ose me qëllimet e veprimtarisë së tyre.”

Neni 43

Neni 50 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 50 Afati i paraqitjes së kërkesës

1. Kërkesat në Gjykatën Kushtetuese për pajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, sipas pikës 1 dhe pikës 3, shkronjat a), b), c), ç) dhe d), të nenit 49 të këtij ligji, mund të paraqiten brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e aktit.
2. Kërkesat për kushtetutshmërinë e ligjit për rishikimin e Kushtetutës, në aspektin procedural, mund të paraqiten brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit.
3. Gjykatat mund ta paraqesin kërkesën në çdo kohë, kur gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore konkrete, sipas nenit 145, pika 2 të Kushtetutës, çmojnë antikushtetutshmërinë e ligjit ose të aktit normativ.
4. Individët mund të paraqesin kërkesë për papajtueshmërinë e ligjit ose të akteve të tjera normative me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara brenda 4 muajve nga konstatimi i cenimit.”

Neni 44

Në nenin 51 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi ekzistues numërohet me numrin “1”;
2. Pas pikës 1, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:
“2. Kur një ligj ose akt normativ ose pjesë të tij që janë objekt shqyrtimi para Gjykatës Kushtetuese shfuqizohen ose ndryshohen para se Gjykata Kushtetuese të marrë vendim, gjykimi pushohet, me përjashtim të rasteve kur ajo çmon se gjykimi duhet të vazhdojë për shkak të një interesi publik ose shtetëror.”

Neni 45

Pas nenit 51 shtohet neni 51/a me këtë përmbajtje:

“Neni 51/a

Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të çështjes vendos:
 - a) Rrëzimin e kërkesës;
 - b) Pranimin tërësisht ose pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e ligjit ose aktit normativ;
2. Në çdo rast Gjykata Kushtetuese në dispozitivin e vendimit shprehet edhe për efektin e vendimit dhe pasojat e tij.”

Neni 46

Në nenin 52 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje për shqyrtimin e këtyre çështjeve vetëm me kërkesë të subjekteve të parashikuara në nenin 134 shkronjat “a”, “b”, “c”, e “ç” të Kushtetutës. Gjykata mund të vihet në lëvizje edhe nga subjektet e parashikuara në shkronjat “d”, “dh” “e”, “ë” “f” “g” “gj”, “h” dhe “i” të Kushtetutës, për çështje që lidhen me interesat e tyre.”
2. Në pikën 3, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Shqyrtimi i kërkesës përfundon brenda tre muajve nga data e paraqitjes së saj.”

Neni 47

Pas nenit 52 shtohet neni 52/a me këtë përmbajtje:

“Neni 52/a
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese pas shqyrtimit të çështjes vendos:
 - a) Deklarimin e marrëveshjes ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën dhe lejimin e ratifikimit të saj nga Kuvendi.
 - b) Deklarimin e marrëveshjes ndërkombëtare të papajtueshme me Kushtetutën dhe ndalimin e ratifikimit të saj nga Kuvendi.
2. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese u njoftohet menjëherë Presidentit, Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave dhe dërgohet për publikim në Fletore Zyrtare.”

Neni 48

Në nenin 53 shtohet titulli me këtë përmbajtje:

“Marrëveshjet ndërkombëtare të miratuara para hyrjes në fuqi të Kushtetutës”.

Neni 49

Në nenin 57 bëhen këto shtesa:

1. Shtohet titulli i nenit me këtë përmbajtje:

“Subjektet kërkuese”;

2. Në pikën1, pas togfjalëshit “jo më pak se një të pestës së deputetëve” shtohet “të Avokatit të Popullit dhe të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.”

Neni 50

Në nenin 58 shtohet titulli i nenit me këtë përmbajtje:
“Kufijtë e shqyrtimit”.

Neni 51

Në nenin 60 shtohet titulli i nenit me këtë përmbajtje:
“Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese”.

Neni 52

Në nenin 61 shtohet titulli i nenit me këtë përmbajtje:
“Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese”.

Neni 53

Neni 62 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 62 Zhvillimi i seancës

1. Gjykata Kushtetuese për kalimin e çështjes në seancë plenare vendos me shumicën e anëtarëve të saj. Në këtë rast zhvillohet seancë plenare publike.
2. Në seancën plenare ftohet të marrë pjesë Presidenti i Republikës, i cili mund të përfaqësohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, si edhe Kuvendi. Gjykata Kushtetuese, sipas rastit, vendos të thërrasë edhe persona të tjerë në gjykim.
3. Mungesa në seancën plenare e Presidentit të Republikës ose e përfaqësuesit të tij pa arsye nuk përbën shkak për moszhvillimin e gjykimit.”

Neni 54

Neni 63 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 63 Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese

1. Kur Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se Presidenti i Republikës ka shkelur rëndë Kushtetutën ose ka kryer një krim të rëndë, deklaron shkarkimin e tij nga detyra. Në këtë rast vendimi i Gjykatës Kushtetuese hyn në fuqi ditën e shpalljes dhe publikohet menjëherë në Fletoren Zyrtare.

2. Kur Gjykata Kushtetuese nuk arrin në përfundimin se Presidenti i Republikës ka shkelur rëndë Kushtetutën ose ka kryer një krim të rëndë, ajo vendos shfuqizimin e vendimit të Kuvendit.
3. Dorëheqja e Presidentit të Republikës nga detyra ose përfundimi i mandatit të tij , pas fillimit të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Kushtetuese, nuk përbën shkak për pushimin e gjykimit të çështjes.
4. Kur vendoset deklarimi i shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, ai nuk përfiton trajtimet e veçanta të parashikuara për funksionarët e lartë.
5. Rregullat e përcaktuara në nenin 61, pikat 1, 2 dhe 3 zbatohen edhe në rastin e vërtetimit përfundimisht të faktit të pamundësisë së përhershme në ushtrimin e detyrës nga Presidenti i Republikës. Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese vendos vërtetimin e faktit të pamundësisë për ushtrimin e detyrës ose rrëzon vendimin e Kuvendit.”

Neni 55

Në nenin 64 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Shtohet titulli i nenit me këtë përmbajtje:
“Shqyrtimi i çështjes”;
2. Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:
“1. Për çështjet që lidhen me zgjedhjen, e Presidentit të Republikës zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të tij, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të jo më pak se një të pestës së deputetëve, ose të partive politike.
2. Në rastin e procedurës së zgjedhjes dhe zgjedhshmërisë, Gjykata Kushtetuese vendos shfuqizimin e vendimit të Kuvendit ose rrëzimin e kërkesës.”

Neni 56

Neni 65 shfuqizohet.

Neni 57

Neni 66 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 66
Subjektet kërkuese

1. Për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Presidentit të Republikës, të jo më pak se 1/5 së deputetëve të Kuvendit ose të partive politike.
2. Për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Kuvendit, ose të një të pestës së deputetëve.
3. Gjykata Kushtetuese verifikon, sipas Kushtetutës, zgjedhjen e deputetëve, me kërkesë të partisë politike ose të kandidatit të pavarur për deputet.”

Neni 58

Pas nenit 66 shtohet neni 66/a me këtë përmbajtje:

“Neni 66/a
Afatet e kërkesës

1. Kërkesa për shqyrtimin e zgjedhshmërisë së deputetëve paraqitet në Gjykatën Kushtetuese brenda 3 muajve nga konstatimi i faktit të pazgjedhshmërisë.
2. Kërkesa për papajtueshmëri të funksionit të deputetit mund të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese për sa kohë vazhdon mandati i deputetit, por jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të mandatit dhe jo më vonë se 3 muaj nga konstatimi i papajtueshmërisë.
3. Gjykata Kushtetuese në këto raste përfundon shqyrtimin e çështjes brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës.”

Neni 59

Në nenin 67 shtohet titulli i nenit me këtë përmbajtje:
“Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese.”

Neni 60

Pas nenit 67 bëhen këto shtesa:

1. Shtohet titulli “Procedurat lidhur me referendumin”;
2. Pas titullit shtohen nenet 67/a, 67/b, 67/c, 67/ç, 67/d, dhe 67/dh, me këtë përmbajtje:

“Neni 67/a
Subjektet kërkuese

1. Kuvendi, kur ndodhet në kushtet e nenit 150, pika 2 dhe 177 të Kushtetutës, ose grupi nismëtar që përfaqëson 50 mijë shtetas me të drejtë vote, kanë të drejtë t’i kërkojnë, Gjykatës Kushtetuese për të kryer verifikimin paraprak të kushtetutshmërisë së çështjes së shtruar për referendum.
2. Gjykata Kushtetuese vendos brenda 60 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

Neni 67/b
Shqyrtimi i çështjes

1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kushtetutshmërisë së çështjeve të shtruara për referendum, Gjykata Kushtetuese vlerëson vlefshmërinë formale dhe materiale të çështjes së shtruar.
2. Gjykata Kushtetuese nuk mund të kontrollojë rëndësinë e çështjeve të veçanta apo kushtetutshmërinë e aktit që do t’i nënshtrohet referendumit.”

Neni 67/c
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese

1. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Kushtetuese vendos:
 - a) deklarimin si të pajtueshme me Kushtetutën të çështjes së shtruar për referendum dhe lejimin e zhvillimit të referendumit;
 - b) deklarimin si të papajtueshme me Kushtetutën të çështjes së shtruar për referendum.
2. Në kushtet kur gjen zbatim shkronja b) e këtij neni, referendumi nuk zhvillohet.”

Neni 67/ç
Verifikimi i rezultatit përfundimtar të referendumit

1. Brenda 10 ditëve nga shpallja e rezultatit përfundimtar të referendumit, subjektet e parashikuara në nenin 134 shkronjat e), f), gj) dhe h) të Kushtetutës, kur çështja lidhet me interesat e tyre, ose grupi nismëtar për zhvillimin e referendumit kanë të drejtë të kërkojnë verifikimin e këtij rezultati nga Gjykata Kushtetuese.
2. Gjykata Kushtetuese jep vendim brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Në raste të veçanta Gjykata Kushtetuese mund të vendosë shtyrjen e afatit me jo më shumë se 30 ditë.”

Neni 67/d
Shqyrtimi i çështjes

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton bazueshmërinë e pretendimeve të natyrës kushtetuese dhe që kanë të bëjnë me ushtrimin e të drejtës së votës nga shtetasit që kanë marrë pjesë në referendum, vlefshmërinë e procesit referendar, si dhe procesin e shpalljes së rezultatit të referendumit.
2. Kur Gjykata Kushtetuese vlerëson si të nevojshëm rinumërimin e votave, ajo urdhëron Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të kryejë një procedurë të tillë.
3. Pas kryerjes së procedurës sipas pikës 2, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i njofton rezultatin Gjykatës Kushtetuese.”

Neni 67/dh
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese

1. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Kushtetuese vendos:
 - a) rrëzimin e kërkesës dhe lënien në fuqi të rezultatit përfundimtar të referendumit;
 - b) shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklarimin e ligjit si të pandryshuar ose të shfuqizuar;
 - c) shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe deklarimin e çështjes ose projektligjit të rëndësisë së veçantë si të miratuar ose jo;
 - ç) përsëritjen e referendumit.”

Neni 61

Në nenin 68 shtohet titulli i nenit me këtë përmbajtje:
“Vënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese.”

Neni 62

Në nenin 69 shtohet titulli i nenit me këtë përmbajtje:
“Shqyrtimi i çështjes”.

Neni 63

Neni 70 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 70
Vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjeve të parashikuara në nenet 68 e 69 të këtij ligji dhe për arsye që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e një ligji konkret, publikon faktin se çështja është nën shqyrtimin e saj.
2. Kur çështja e paraqitur nga Gjykata e Lartë kalon për gjykim në seancë plenare, gjykatat e tjera pezullojnë çështjet në gjykim, për të cilat gjen zbatim ligji i kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese.
3. Në rastet kur Gjykata Kushtetuese e shfuqizon ligjin si antikushtetues, vendimin e saj ia njofton Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave.”

Neni 64

Pas nenit 70, shtohet titulli me këtë përmbajtje:
“Procedura për shqyrtimin e ankimit kushtetues individual”.

Neni 65

Neni 71 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 71
E drejta për të ushtruar ankimin kushtetues individual

1. Çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, kur është palë në një proces ligjor ose kur është bartës i të drejtave dhe i lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta ka të drejtë të kundërshtojë para Gjykatës Kushtetuese çdo akt që cenon të drejtat dhe liritë e parashikuara në Kushtetutë, sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71/a të këtij ligji.
2. Objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, sipas nenit 49, pika 3 të këtij ligji.

3. Gjykata Kushtetuese shqyrton përfundimisht ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas nenit 140, pika 4 dhe 148/d të Kushtetutës.

Neni 66

Pas nenit 71 shtohen nenet 71/a, 71/b, 71/c, 71/ç dhe 71/d, me këtë përmbajtje:

“Neni 71/a

Kriteret për të ushtruar ankim kushtetues individual

1. Ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese kur:
 - a) Kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese ose kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në dispozicion;
 - b) Kërkesa paraqitet brenda afatit 4 mujor nga konstatimi i cenimit;
 - c) Pasojat negative të pretenduara janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuesin;
 - ç) Shqyrtimi i çështjes nga Gjykata Kushtetuese do të mund të rivendoste në vend të drejtën e shkelur të individit.
2. Përveç kriterëve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, gjejnë zbatim rregullimet e parashikuara në këtë ligj për shqyrtimin paraprak.”

Neni 71/b

Shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese

1. Gjykata Kushtetuese shqyrton nëse akti, pjesërisht ose tërësisht, është në përputhje me Kushtetutën dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. Gjykata Kushtetuese mund të shprehet edhe për dispozita të tjera që nuk janë objekt i kërkesës, në rast se çmon se kanë lidhje me çështjen në gjykim.
2. Kur Gjykata Kushtetuese shqyrton kushtetutshmërinë e një akti dhe arrin në përfundimin se ai bazohet mbi një ligj ose akt normativ antikushtetues, Gjykata vendos njëkohësisht edhe shfuqizimin e ligjit ose aktit normativ.
3. Në rastet kur gjen zbatim pika 2 e këtij neni, efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nuk shtrihen ndaj akteve që kanë përfunduar efektet ose vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë të prerë.
4. Gjykata Kushtetuese e shqyrton kërkesën brenda një afati të arsyeshëm.”

Neni 71/c

Detyrimet që rrjedhin nga vendimmarrja e Gjykatave Ndërkombëtare

1. Për qëllimet e këtij ligji, Gjykatat Ndërkombëtare janë ato gjykata, juridiksioni i të cilave shtrihet ndaj shtetit shqiptar, si pasojë e detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.
2. Nëse një gjykatë ndërkombëtare konstaton se Republika e Shqipërisë ka shkelur detyrimin që rrjedh nga një marrëveshje ndërkombëtare dhe si rrjedhojë janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të një personi fizik ose juridik nëpërmjet një ligji ose akti normativ, Gjykata

Kushtetuese, me kërkesë, mund të shfuqizojë ligjin ose aktin normativ nëse konstaton se nuk ka mjet tjetër efektiv për të vënë në vend të drejtat e cenuara.

3. Nëse Gjykata Kushtetuese ka vendosur më parë mbi një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, subjekti i cenuar në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës Kushtetuese për rihapje të procesit gjyqësor.

4. Kërkesa për rihapje të procesit para Gjykatës Kushtetuese paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Ajo duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë si dhe kërkimet konkrete. Kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit dhe shfuqizimin e aktit.

5. Kërkesa për rihapje të procesit nuk pranohet nëse:

- a) pasojat e cenimit të të drejtave dhe lirive themelore nuk ekzistojnë më;
- b) gjykata ndërkombëtare ka dhënë një dëmshpërblim, pa e shoqëruar me rihapje të procesit (*just satisfaction*);
- c) cenimi është mënjtuar nga një rregullim i ri ligjor ose forma të tjera.

6. Gjykata Kushtetuese, kur pranon kërkesën, vendos:

- a) shfuqizimin e vendimit të mëparshëm të saj dhe pranimin e kërkesës;
- b) shfuqizimin e vendimit të mëparshëm të saj dhe njëkohësisht të aktit që ka cenuar të drejtat dhe liritë themelore të kërkuesit dhe detyrimin e organit kompetent të nxjerrë një akt të ri ose detyrimin e organit të mos veprojë, sipas rastit.”

Neni 71/ç

Shqyrtimi i kërkesave për tejkëqim të procesit para Gjykatës Kushtetuese

1. Kushdo që është palë në një proces që zhvillohet para Gjykatës Kushtetuese ose palë në një proces gjyqësor të pezulluar si rrjedhojë e një kontrolli incidental ose shqyrtimi të kushtetutshmërisë së ligjit të iniciuar nga subjekte të tjera të parashikuara në nenin 134 të Kushtetutës, dhe pretendon se gjykimi është zhvilluar tej afatit të arsyeshëm, ka të drejtë të kërkojë shpërblim të drejtë nga Gjykata Kushtetuese, nëse konstatohet se nga tejkëqimi e procesit atij i janë cenuar të drejtat dhe liritë e tij të parashikuara nga Kushtetuta.

2. Në çdo rast, pavarësisht pasojave, kërkuesi nuk mund të paraqesë kërkesë pa kaluar të paktën një vit nga fillimi i shqyrtimit të çështjes.

3. Gjykata Kushtetuese në çdo rast vlerëson natyrën e procesit dhe të çështjes, si dhe rrethanat që kanë ndikuar në procesin vendimmarrës të Gjykatës Kushtetuese. Ajo vendos për masën e dëmshpërblimit, duke iu referuar pasojave që i kanë ardhur kërkuesit nga tejkëqimi e procesit para saj.

4. Nëse Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se gjykimi është zgjatur tej afatit, pa shkak të arsyeshëm, atëherë ajo dëmshpërblen kërkuesin deri në masën 100.000 lekë për çdo vit vonesë.”

Neni 71/d

Shqyrtimi i kërkesave sipas nenit 179/1 të Kushtetutës

1. Gjykata Kushtetuese, me kërkesë të jo më pak se 1/5 së deputetëve të Kuvendit, shqyrton rastet e parashikuara nga neni 179/1 të Kushtetutës.”
2. Gjykata Kushtetuese në këtë rast shqyrton nëse ndodhet në kushtet e mosveprimit të organeve të ngarkuara nga Kushtetuta apo ligji për konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të zyrtarit të zgjedhur, të emëruar apo funksionarit të lartë publik.
3. Gjykata Kushtetuese në fund të shqyrtimit vendos:
 - a) Rrëzimin e kërkesës;
 - b) Konstatimin e mbarimit apo pavlefshmërisë së mandatit, ose shkarkimin nga detyra të funksionarit të lartë publik.”

Neni 67

Në nenin 72, pika 6 ndryshohet si më poshtë:

“6. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese shpallet i arsyetuar. Në raste të veçanta që kanë të bëjnë me çështje të rëndësisë publike, Gjykata Kushtetuese mund të njoftojë dispozitivin e vendimit menjëherë pas marrjes së tij dhe shpall vendimin e arsyetuar brenda 5 ditëve. Në këtë rast, vendimi hyn në fuqi ditën e shpalljes së tij bashkë me arsyetimin, përveç rasteve kur Gjykata vendos ndryshe.”

Neni 68

Në nenin 73, pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.”

Neni 69

Neni 74 shfuqizohet.

Neni 70

Neni 76 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 76

Efektet juridike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

1. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese është përfundimtar dhe i detyrueshëm për zbatim.
2. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull sjell efekte juridike nga data e hyrjes së tij në fuqi, përveç rasteve të parashikuara ndryshe nga ky ligj.
3. Gjykata Kushtetuese, në çdo rast, shprehet edhe për efektet e vendimit të saj.
4. Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që vendimi për shfuqizimin e një akti të prodhojë pasoja në një datë tjetër të ndryshme nga hyrja e tij në fuqi. Në këtë rast Kuvendi apo çdo institucion tjetër bën ndryshimet e nevojshme brenda afatit të përcaktuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në përputhje me pjesën arsyetuese të tij.

5. Kur Gjykata Kushtetuese gjatë shqyrtimit të një çështje konstaton se ka boshllëk ligjor si rrjedhojë e të cilit kanë ardhur pasoja negative për të drejtat dhe liritë themelore të individit, ajo, veç të tjerave, vendos detyrimin e ligjvënësit për të plotësuar kuadrin ligjor brenda një afati të caktuar.

6. Vendimet e gjykatave të çdo shkalle, të cilat shfuqizohen nga Gjykata Kushtetuese, nuk kanë fuqi juridike nga momenti i marrjes së tyre. Çështja i dërgohet për shqyrtim gjykatës, vendimi i të cilës është shfuqizuar.

7. Vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm:

a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar;

b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë;

c) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar.”

Neni 71

Neni 77 shfuqizohet.

Neni 72

Neni 79 shfuqizohet.

Neni 73

Neni 80 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 80

Saktësimi dhe plotësimi i vendimit

1. Gjykata Kushtetuese ka të drejtë, me kërkesë, të ndreqë gabimet në shkrim, në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të lejuar në vendim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit.

2. Pas shqyrtimit të këtyre rasteve, Gjykata Kushtetuese merr vendim, i cili publikohet në Fletoren Zyrtare.”

Neni 74

Në nenin 81, pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. Gjykata Kushtetuese në varësi të llojit të vendimit dhe kur është e nevojshme, mund të caktojë në pjesën urdhëruese organin e ngarkuar me zbatimin e vendimit, si dhe mënyrën e ekzekutimit, duke caktuar afate konkrete, mënyrën dhe procedurën përkatëse të ekzekutimit.

4. Moszbatimi ose pengimi i ekzekutimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dënohet sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal.”

Neni 75

Neni 82 shfuqizohet.

Neni 76

Neni 83 shfuqizohet.

Neni 77

Neni 84 shfuqizohet.

Neni 78

Neni 85 shfuqizohet.

Neni 79

Neni 86 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 86 Zbatimi i ligjit të ri

1. Shqyrtimi i shkeljeve disiplinore të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, sipas nenit 10 të këtij ligji, për një periudhë 9 vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji, do të bëhet nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, sipas parashikimeve të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”.
2. Këshilltarët ligjorë që janë emëruar para hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë të qëndrojnë në detyrë, nëse përfundojnë me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, sipas nenit 179/b dhe Aneksit të Kushtetutës si dhe ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Këshilltarët ligjorë që ndjekin karrierën e magjistratit i nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për statusin e magjistratit. Këshilltarët e tjerë ligjorë i nënshtrohen rregullave të parashikuara në këtë ligj dhe në ligjin për statusin e magjistratit, për aq sa ai gjen zbatim. Këshilltarët ligjorë që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 14/a të këtij ligji brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e tij, transferohen në një detyrë tjetër në administratën e Gjykatës Kushtetuese ose si nëpunës civilë gjyqësorë pranë gjykatave ose prokurorisë, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Për kërkesat dhe çështjet që janë në shqyrtim datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen dispozitat e këtij ligji, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenet 50 pika 4, 71, 71/a, 71/b, 71/c dhe 71/ç të këtij ligji, për të cilat zbatimi do të fillojë në datën 1 mars 2017.”
4. Përtëritja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese deri në vitin 2022, kur të gjejë zbatim përtëritja e rregullt sipas pikës 1 të këtij neni, do të bëhet sipas skemës së parashikuar më poshtë:
 - a) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët të cilëve u mbaron mandati në vitin 2016 emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi.
 - b) Gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2017 zgjidhet nga Gjykata e Lartë dhe qëndron në detyrë deri në vitin 2025.
 - c) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët që u mbaron mandati në vitin 2019 emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës dhe nga Kuvendi.
 - ç) Gjyqtari që do të zëvendësojë gjyqtarin, të cilit i mbaron mandati në vitin 2020 zgjidhet nga Gjykata e Lartë dhe qëndron në detyrë deri në vitin 2028.

d) Gjyqtarët që do të zëvendësojnë gjyqtarët, të cilëve u mbaron mandati në vitin 2022 emërohen sipas radhës, përkatësisht nga Presidenti i Republikës, nga Kuvendi dhe nga Gjykata e Lartë.

Neni 80
Hyrja në fuqi e ligjit

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare